ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Një ankesë kundër: Vendimit të dt.15.11.2021 i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP:**216-21-5975-2-2-1** dhe nr. të brendshëm **216/21/009/221**

Sa i përket tenderit për **Shëbime postare Diplomatike-ri tender**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit

A.L.Dushi Sh.p.k.

rruga Kosta Novakoviq C4\2, lam.B,nr.5,
(Adresa)

Prishtinë 10000
(Vendi) *(Kodi Postal)*

+38344178587 -
(Numri i telefonit)(Numri i faksit)

Xhylizare Selimi Dushi
(emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

xhylid@aldushi.com
(adresa elektronike)

24.11.2021
(data e parashtrimit të ankesës)

(nënshkrimi dhe vula)

A.L. Dushi SH.P.K.

***Ankues mund të jetë pala e interesuar (operatori ekonomik apo grupi i operatorëve ekonomik pjesëmarrës në aktivitetin e prokurimit).*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me<u>PROKURË.</u>

Shëno të dhënat si në vijim:

(emri i avokatit)

_____

(adresa e plotë)

_____ _____

(numri i telefonit) *(numri i faksit)*

_____

(adresa elektronike)

_____ _____

(data e parashtrimit të ankesës) *(nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Një përshkrim i shkurtër lidhur me datën dhe emrin e gazetës (ve) ditore në të cilën (at) është publikuar " Njoftimi për Kontratë" si dhe "Njoftimi për dhënie të Kontratës", afati i fundit për dorëzimin e tenderit, data dhe ora e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

*Në pajtim me të gjitha dispozitat ligjore për konkurrim në tender publik, kompania A.L.Dushi Shpk ka aplikuar në tenderin me titull: "***Sherbime postare Diplomatike***"ri-tender , dosja e shpallur ne eprokurim me datën 03.09.2021.*
*Njoftimi i parë mbi **Vendimin e Autoritetit Kontraktues është bërë më dt.20.10.2021** ndërsa i dytë mbi **Vendimin e Autoritetit Kontraktues është bërë më dt.09.11.2021** ,kurse OE ka dorëzu **kërkesën e parë për rishqyrtim në Vendimin e Parë më datë 22.10.2021 dhe tjetrën kërkesa për rishqyrtim në Vendimin e Dytë më datë 12.11.2021**, ku Autoriteti Kontraktues Kërkesën e parë ka aprovuar pjesërisht me datën 03.11.2021,ndërsa të dytën ka refuzuar me datën 15.11.2021.*

4. Procesi i Hapjes së tenderëve

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shtesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:

Po [x] **Jo** [ ]

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë e gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti tëprokurimitme publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës:

Konsiderojmë se janë shkelur dispozitat ligjore si në vijim:

- *Neni 10 par.3, 4, 5 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurim Publik.*
- *Neni 11 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurim Publik.*
- *Neni 108A të Ligjit nr.04/L-042 për Prokurim Publik.*
- *Neni 61 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurim Publik.*
- *Neni* 36 të Ligjit nr.05/L -068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit LPP, nr.04/L-042 Neni 58, paragrafin 3.

*** Sipas nenit 113 të LPP-së, OSHP-ja do të konfiskoj Sigurimin e Ankesës tuaj, nëse Paneli Shqyrtues konstaton se të gjitha apo cilado nga pretendimet e bëra në ankesë kanë qenë të rrejshme apo mashtruese.*

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Në pajtim me të gjitha dispozitat ligjore për konkurrim në tender publik, kompania A.L.Dushi Sh.p.k., Kosta Novakoviq C4/2 LAM.B Nr.5,10000, Prishtinë - Kosovë, ka aplikuar në tenderin me titull: "Shërbime Postare Diplomatike" ri-tender, dosja e shpallur në e-prokurim me datën 03.09.2021. Afati i fundit për aplikim ka qenë 15.09.2021, kriter për dhënien e kontratës është tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët sipas peshimit.

Hapja publike është bërë me dt.15.09.2021 përmes platformës së E-prokurimit, gjithësjet kanë marr pjesë tre tender - oferta.

Njoftimi i parë mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues-Letër standarde për tenderuesin e pasuksesshëm është bërë më dt.20.10.2021, i cili njoftim sipas Vendimit të MPJD-së, të dt.03.11.2021, dhe çështja është kthyer në rivlerësim.

Vendimin i dytë i Autoritetit Kontraktues-Letër standarde për tenderuesin e pasuksesshëm është bërë më dt.08.11.2021. Kundër këtij vendimi pala kompania A.L.Dushi Sh.p.k., Prishtinë, e pa kënaqur me këtë vendim, me dt. 12.11.2021 bënë kërkesë për rishqyrtim, e cila kërkesë është Refuzuar nga MPJD, me Vendimin e dt.15.11.2021.

Andaj duke pasur parasysh gjithë rrjedhën e procedurës, si dhe vendimin e refuzuar nga ana e MPJD-së, pala ankuese konsideron se i njëjti vendim përsëri është marr me shkelje të dispozitave procedurale si dhe është i pa arsyetuar në prova dhe fakte relevante për çështjen.

Njoftimi i dytë për tenderuesin e pasuksesshëm i datës 08.11.2021 i cili e hap procesin e prokurimit me nr.216-21-5975-2-2-1 dhe nr. të brendshëm 216-21-009-221 për Shërbime postare Diplomatike - Ri tender, është proces jo-ligjor i cili nuk ka bazë juridike meqenëse MPJD ende nuk e ka përmbyll procesin e Prokurimit për Njoftimin e Kontratës me nr. të prokurimit 216-21-2353-2-1-1 dhe me nr. të brendshëm 216-21-009-211 për "Shërbimet postare Diplomatike" i shpallur me 25.06.2021, proces i cili është marr në shkelje të LPP si më posohtë:

- *Neni 10 par.3, 4, 5 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurim Publik.*
- *Neni 11 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurim Publik.*
- *Neni 108A të Ligjit nr.04/L-042 për Prokurim Publik.*
- *Neni 61 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurim Publik.*

Bauzar në nenin 10 të LPP-së, sipas të cilit përcaktohet transparenca e plotë gjatë procesit të prokurimit dhe çasja në dokumente edhe të OE Fitues, për arsye se çmimi i ulët i të njëjtit është në kundërshtim me nenin 61 të LPP-së, për shkak se më këtë çmim nuk mund të mbulohen shërbimet e ofruara dhe të kontraktuara, ashtu që pala ka bërë kërkesë për çasje në dokumente me dt.11.11.2021, mirëpo një kërkesë e tillë është refuzuar me pretendimin kinse lista e çmimeve nga OE fitues është konfidenciale, e kjo në kundërshtim me nenin 11 të LPP-së, për shkak se lista e çmimeve nuk është sekret afarist dhe ska të bëjë më asgjë konfidenciale dhe një refuzim i tillë është edhe në kundërshtim me Ligjin për çasje në dokumente publike.
Me këtë veprim është shkel edhe neni 108/A, të Ligjit Nr. 05/L -06, lidhur me nenin 10 paragrafët 3, 4 dhe 5 të LPP-së, për shkak se si palë e interesuar kemi të drejtë të kemi çasje të pa penguar dhe të menjëhershme në të gjitha dokumente që nuk përbejnë sekrete afariste, dhe është shumë e qartë se lista e çmimeve të OE fitues nuk është sekret afarist në asnjë rrethanë, pavarësisht faktit se në momentin e plotësimit të kërkesës për

konfidencialitet që të hy edhe lista e çmimeve, kjo nuk do të thotë se në mënyrë automatike kjo listë "përbën sekret afarist", sepse nuk po kërkohen të dhëna lidhur me shërbimet dhe produktet që i ofrojnë por me listën e çmimeve për secilin shërbim dhe mallë që ofrojnë, për shkak se çmimi i ofruar nga OE fitues në asnjë rast nuk e arsyeton çmimin real për këto shërbime për shkak se janë çmime jo-normalisht të ulëta sipas nenit 61 të LPP-së.

Mbeshtetur në nenin 11, pika 2 e LPP nr. 04/L-042 parasheh që "*Informatat që sipas paragrafit 3. të nenit 58 të këtij ligji duhet të shpallen dhe regjistrohen gjatë hapjes publike të tenderëve nuk mund të klasifikohen si informata sekrete afariste.*" Rrjedhimishte: sipas nenit 36 të Ligjit nr.05/L -068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit LPP, nr.04/L-042 Nenin 58, paragrafin 3 në mënyrë shumë të qartë e përcakton se çka parashihet se çka nuk mund të klasifikohet si informatë konfidenciale "*Zyrtari përkatës i prokurimit e bën hapjen e tenderëve. Gjatë hapjes së çdo tenderi, Zyrtari i Prokurimit do t'u lexojë me zë atyre që janë të pranishëm: (i) emrin dhe vendin e tenderuesit, (ii) çmimin e përgjithshëm të tenderit të specifikuar në tenderin e tillë dhe, kurdo që është e mundur, çmimet për njësi, përveç kur dokumenti përkatës është vetëm komponenti i propozimit teknik të tenderit dypjesësh, dhe ndonjë vërejtje. Kur për arsye të jo atypëratyshme çmimet për njësi nuk mund të lexon, çmimet e tilla në çdo rast duhet të bëhen të dukshme gjatë hapjes publike për të gjithë përfaqësuesit e ofertuesve, si për shembull duke bërë postimin e tyre ose duke përdorur ndonjë tjetër metodë adekuate e cila garanton transparencë*".

Në bazë të Nenit 58, paragrafit 3 të LPP-së, MPJD është e obliguar që të shpalos çmimet e ofertuesve dhe të njëjtat nuk mund ti konsideron konfidenciale. MPJD nuk mund të refuzon kërkesën tonë të drejtuar më datën 11.11.2021 sepse në bazë të dispozitave të sipërpërmendura të LPP, sipas të cilit Ligj operatori ekonomik nuk mund të klasifikoj si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi, pavarësisht faktit se në momentin e plotësimit të kërkesës për konfidencialitet nga cila do pale edhe mund të jetë kërkuar që kjo listë të jetë sekret afarist, mirëpo një gjë të tillë nuk e përcaktojnë palët por e përcakton ligji i aplikueshmëm.

Me këtë veprim ZPP e MPJD gjithë ashtu e cenon në mënyrë të drejtëpërdrejtë edhe Nenin 10, 11 dhe 58 sepse arsyetimi se kinse lista e çmimeve është konfidenciale nuk mund të konsiderohet si arsyetim ligjor përderisa nuk ka asnjë bazë ligjore sepse siç u sqarua më lartë nuk është as konfidenciale edhe as sekret afarist lista e çmimeve të opertorëve të tjerë, por vetëm shkelje e këtyre dispozitave ligjore dhe mungesë e transparences nga ZPP e MPJD.
Njoftimi nr. Prok 216-21-5975-2-2-1 dhe nr.intern 216-21-009-221, për fituesin 3P Sh.p.k., me çmim për peshim 235.00 €, është marrë në kundërshtim me nenin 61 të LPP-së, për shkak se ky çmim është jo normalisht i ulët dhe nuk është në përputhje me vlerën reale të shërbimeve të ofruara dhe në asnjë rast me këtë çmim të ofruar nuk mund të përmbyllen dhe përmbushen obligimet kontraktuese.

Sipas Njoftimit të bërë nga ana e Autoritetit Kontraktues të datës 08.11.2021 për procesin e prokurimit 216-21-2353-2-1-1 gjatë hapjes së ofertave Kompania 3P Sh.p.k. del fituese e tendërit për Shërbimet postare diplomatike, sipas vlerësimit të çmimit më të ulët.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:

Me shpalljen e fituesit të procesit të prokurimit 216-21-2353-2-1-1, janë bërë shkelje të Neneve 10 par.3, 4, 5, nenit 11, nenit 108/A dhe nenit 61 të LPP, shkelje e cila ka dëmtuar Kompaninë A.L.Dushi në vlerë prej 90,000.00 euro (nëntëdhjetëmijë euro - vlera e RI-tenderit) për afat kontraktues një (1) vjeçar.

9. Propozim

Ofroni, nëse është e mundur propozimin tuaj për hapat e mëtutjeshëm në lidhje me këtë aktivitet të prokurimi:

Që Organin Shqyrtues të Prokurorimit, me seli në Prishtinë, ta APROVOJ ankesën si të BAZUAR, Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës – Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, dt.15.11.2021 që të njëjtin ta PRISHË dhe çështja të kthehet në rivendosje në organin e shkallës së parë.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Regjistroni secilën dëshmi të cilën do t'ibashkëngjitni ankesës tuaj. Në mënyrë që ankesa juaj të merret në shqyrtim, duhet të ketë të bashkangjitur patjetër ***Publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës*** *me të cilën do të dëshmohet data si dhe emri i gazetës në të cilën është publikuar ky njoftim apo njoftimin e kandidatëve dhe tenderuesve të eliminuar, procesverbalin e hapjes publike të tenderëve, si dhe të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë mekëtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

1. Njoftimi i parë mbi Vendimin e AK datës 20.10.2021
2. Kërkesa për rishqytrim e datës 22.10.2021
3. Vendimi i AK mbi kërkesën për rishqytrim e datës 03.11.2021
4. Vendimi mbi Pezullimin e procesurës e datës 02.11.2021
5. Njoftimi i dytë mbi Vendimin e AK i datës 08.11.2021
6. Kërkesa për rishqytrim e datës 12.11.2021
7. Vendimi i AK mbi kërkesën për rishqytrim e datës 15.11.2021
8. Kërkesa për casje ne dokumentat e OE 3P Shpk e datës 11.11.2021

*** Sipas nenit 106.2 të LPP-së, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës në fjalë, do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe më pas një kopje të protokolluar nga OSHP-ja do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*